


# Treguesit demografikë

## Tremujori I 2017


**Tiranë, më 28 qershor 2017:** Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e parë 2017, pasqyron një rënie me 33,6 %, në krahasim me tremujorin e parë 2016. Gjatë kësaj periudhe numri i lindjeve tejkaloi me 852 numrin e vdekjeve.

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë, T1 2016 – T1 2017



Në tremujorin e parë 2017, shtesa natyrore e popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë, regjistron normën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 639 numrin e vdekjeve. Në qarqet Elbasan, Durrës, Dibër, Lezhë dhe Fier shtesa natyrore është pozitive. Vlera më e ulët është regjistruar në Qarkun e Korçës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 160 numrin e lindjeve.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T1 2017



### Lindjet

Numri i lindjeve për tremujorin e parë 2017, rezulton 6.880 duke shënuar një rënie me 4,0 %, në krahasim me tremujorin e parë 2016.

Numri më i ulët i lindjeve regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 138 lindje, me një rënie prej 10,4 %, në krahasim me tremujorin e parë 2016. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.087 lindje, të cilat shënojnë rritje me 1,5 %, në krahasim me tremujorin e parë 2016.

Qarku i Tiranës dhe qarku i Vlorës janë qarqet e vetme që pësuan rritje të numrit të lindjeve në tremujorin e parë 2017, krahasuar me tremujorin e parë 2016, edhe pse kjo rritje rezulton shumë e vogël. Rënie më të madhe të numrit të lindjeve gjatë kësaj periudhe e paraqet qarku i Beratit me 14,3 %.

**Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve, T1 2016 – T1 2017**

Qarqet	I-16	II - 16	III - 16	IV-16	I-17
<b>Shqipëria</b>	7.163	7.365	9.086	8.119	6.880
1 Berat	343	313	377	380	294
2 Dibër	381	450	525	431	369
3 Durrës	725	751	951	833	709
4 Elbasan	774	739	903	871	716
5 Fier	771	681	899	851	711
6 Gjirokastrë	154	131	194	168	138
7 Korçë	464	540	575	481	429
8 Kukës	259	319	301	262	237
9 Lezhë	356	352	461	407	327
10 Shkodër	465	483	590	535	447
11 Tiranë	2.057	2.207	2.787	2.459	2.087
12 Vlorë	391	363	488	414	392
Të panjohur*	23	36	35	27	24

\*Kategoria **"Të panjohur"** nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.

### Vdekjet

Numri i vdekjeve për tremujorin e parë 2017 rezulton 6.031, duke shënuar një rritje prej 2,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Numri më i madh i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 1.448 vdekje duke shënuar një rritje prej 6,3 %, në krahasim me tremujorin e parë 2016. Numri i vdekjeve është rritur pothuajse në çdo qark në tremujorin e parë të vitit 2017 në krahasim me tremujorin e parë 2016.

Rritja më e madhe është regjistruar në qarkun e Dibrës me 7,8 %. Qarku i Elbasanit shënoi rënien më të madhe të numrit të vdekjeve me 2,7 %, pasuar nga qarku i Shkodrës me 0,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2016.

**Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve, T1 2016 – T1 2017**

Qarqet		I-16	II - 16	III – 16	IV-16	I-17
<b>Shqipëria</b>		<b>5.880</b>	<b>5.046</b>	<b>4.680</b>	<b>5.782</b>	<b>6.031</b>
<b>1</b>	Berat	334	273	241	320	338
<b>2</b>	Dibër	244	219	210	264	263
<b>3</b>	Durrës	546	440	428	522	552
<b>4</b>	Elbasan	595	516	442	524	579
<b>5</b>	Fier	658	506	497	652	677
<b>6</b>	Gjirokastër	214	203	185	207	217
<b>7</b>	Korçë	579	516	486	559	589
<b>8</b>	Kukës	143	130	98	141	147
<b>9</b>	Lezhë	257	275	211	255	265
<b>10</b>	Shkodër	527	413	401	482	522
<b>11</b>	Tiranë	1.362	1.179	1.116	1.438	1.448
<b>12</b>	Vlorë	418	373	357	412	429
	Të panjohur*	3	3	8	6	5

\* Kategoria **'Të panjohur'** nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.

# Shënime metodologjike

## Përkufizime:

**Shtesa natyrore e popullsisë:** Shpreh rritjen/rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

**Lindje e gjallë:** Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

**Vdekje:** nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.